



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 12

10 shkurt

2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 2/2014 datë 30.1.2014	Për miratimin e përbërjes së Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrative-Territoriale në Republikën e Shqipërisë.....	219
Vendim i Kuvendit nr. 3/2014 datë 30.1.2014	Për mosdhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Petrit Çeno anëtar i Gjykatës së Lartë.....	219
Vendim i Kuvendit nr. 4/2014 datë 30.1.2014	Për mosdhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Gjovalin Përnoca anëtar i Gjykatës së Lartë.....	220
Vendim i KM nr. 53, datë 5.2.2014	Për përcaktimin e marzheve të fabrikimit dhe të tregtimit të barnave.....	220
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Klement Metushi...	222

**VENDIM
Nr. 2/2014**

**PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR REFORMËN
ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 77, pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Miratohet përbërja e Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë, si më poshtë:

- | | | |
|--------------------|-----|-----------------|
| 1. Bashkim Fino | PS | (bashkëkryetar) |
| 2. Blendi Klosi | PS | (anëtar) |
| 3. Armando Subashi | PS | (anëtar) |
| 4. Musa Ulqini | PS | (anëtar) |
| 5. Namik Kopliku | PS | (anëtar) |
| 6. Andrea Marto | PS | (anëtar) |
| 7. Petrit Vasili | LSI | (anëtar) |
| 8. Spartak Braho | LSI | (anëtar). |

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miratuar në datën 30.1.2014

**VENDIM
Nr. 3/2014**

**PËR MOSDHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ZOTIT PETRIT ÇENO ANËTAR I
GJYKATËS SË LARTË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136, pika 1 të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8395, datë 22.11.2013,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

- I. Mosdhënie e pëlqimit për emërimin e zotit Petrit Çeno anëtar i Gjykatës së Lartë.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miratuar në datën 30.1.2014



VENDIM
Nr. 4/2014

**PËR MOSDHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ZOTIT GJOVALIN PËRNOCA
ANËTAR I GJYKATËS SË LARTË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136, pika 1 të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8396, datë 22.11.2013,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Mosdhënie e pëlqimit për emërimin e zotit Gjovalin Përnoca anëtar i Gjykatës së Lartë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 30.1.2014

VENDIM
Nr. 53, datë 5.2.2014

**PËR PËRCAKTIMIN E MARZHEVE TË FABRIKIMIT DHE TË TREGTIMIT TË
BARNAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 50 të ligjit nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Çmimi maksimal i tregtimit të barnave nga fabrikuesit vendas caktohet duke shtuar deri në 20 (njëzet) për qind mbi koston e fabrikimit. Ky çmim maksimal i tregtimit llogaritet bazuar mbi çmimin EXW.
2. Çmimi maksimal i tregtimit me shumicë të barnave nga importuesit dhe shpërndarësit farmaceutikë caktohet duke shtuar deri në 11 (njëmbëdhjetë) për qind mbi çmimin CIF të importit të barit, e konvertuar në lekë sipas kursit mesatar të njoftuar nga Banka e Shqipërisë, për çdo 6-mujor. Marzhi 11 (njëmbëdhjetë) për qind ndahet ndërmjet importuesit dhe shpërndarësit, përkatësisht 8 (tetë) për qind dhe 3 (tre) për qind.
3. Çmimi maksimal i tregtimit me pakicë të barnave caktohet duke shtuar deri në 25 (njëzet e pesë) për qind mbi çmimin e blerjes nga shpërndarësi farmaceutik.
4. Për barnat e listës, që rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, zbatohen marzhe të diferencuara, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Për barnat, që blihen nga institucionet shëndetësore publike, çmimi maksimal i tregtimit dhe marzhi i fitimit, që do të zbatohen mbi çmimin CIF ose EXW, do të jetë me marzhe të diferencuara, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Për barnat, të cilat nuk janë përfshirë në listën bashkëlidhur, do të zbatohet një marzh fitimi deri në 8 (tetë) për qind.

6. Vendimi nr. 543, datë 27.7.2011 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e marzheve të fabrikimit dhe të tregtimit të barnave”, shfuqizohet.

7. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela nr. 1

TABELA E GRUPEVE TË BARNAVE PËR PËRDORIM NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE NË VEND DHE MARZHET E FITIMIT QË DO TË ZBATOHEN MBI ÇMIMIN CIF ose EXW TË TYRE.

- GRUPI I

PËR GRUPIN E MËPOSHTËM TË BARNAVE DO TË ZBATOHET NJË MARZH FITIMI DERI NË 8 (TETË) PËRQIND.

1. Anestezi reanimacion
2. Dermatologjike
3. Hormonale
4. Organeve sensoriale
5. Metabolizmi dhe trakti tretës
6. Psikiatri
7. Sistemi kardiovaskular
8. Sistemi muskolo-skelektik
9. Sistemi nervor
10. Sistemi respirator

- GRUPI II

PËR GRUPIN E MËPOSHTËM TË BARNAVE DO TË ZBATOHET NJË MARZH FITIMI DERI NË 6 (GJASHTË) PËRQIND.

1. Antiinfektive
2. Gjaku dhe organet formuese të gjakut
3. Cítostatikë



KËRKESE

Shtetasja Mynevere Metushi, lindur në Kuç, banuese në Berat, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, shpalljen të vdekur të djalit të saj, shtetasit Klement Metushi, i datëlindjes 6.12.1975.

KËRKUESJA
Mynevere Metushi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 8 lekë